



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 06.11.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 06.11.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **ADRA GROUP CONSTRUCTION SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **“Ndërtimi i objektit te ri për Institutin Special ne Shtime”** me nr. prokurimi 206-24-187-5-1-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Pranohet**, si pjeserisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE ADRA GROUP CONSTRUCTION SH.P.K. e datës 06.11.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Ndërtimi i objektit te ri për Institutin Special ne Shtime”** me nr. prokurimi 206-24-187-5-1-1, kundër Njoftimit për Kontrate, të datës 17.10.2024 te publikuar ne platformën elektronike;
- II. **Vërtetohe**, kriteret sipas Njoftimit për Kontrate te datës 17.10.2024 dhe Formulari standard per korrigjim-B54 te dates 01.11.2024;
- III. Autoriteti Kontraktues, e shtyne afatin per ofertim me dt. 18.11.2024;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik ADRA GROUP CONSTRUCTION SH.P.K. me datë 06.11.2024 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndërtimi i objektit te ri për Institutin Special ne Shtime”** me nr. prokurimi 206-24-187-5-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 06.11.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

NENI 1 I LPP-SE
NENI 6 I LPP-SE
NENI 7 I LPP-SE,paragrafi 6
NENI 27 I LPP-SE, paragrafi 4
NENI 28 I LPP-SE
NENI 29 I LPP-SE

Neni 6 paragrafi 6.6 i RRPP-SE
Neni 17 paragrafi 17.5,17.17,17.18 i RRPP-se
Neni 19 paragrafi 19.1 i RRPP-SE
Neni 20 i RRPP-SE

Pretendimet ankimore te OE ankues:

HISTORIA E AKTIVITETIT NE FJALE

Lidhur me kete aktivitet te prokurimit ne se OE i interesuar per kete aktivitetet paraqesim kerkese per rishqyrtim me daten 06.11.2024, duke u bazuar ne afate ligjore, kerkesa per rishqyrtim bazohet me specifikat dhe shkeljet qe AK ka vepruar gjate inicimit te aktivitetit te prokurimit, dhe se ju i njejti AK keni vazhduar me keto shkelje,

Me daten 17.10.2024 dosja e tenderit eshte dorezuar ne KRPP edhe poashtu e njejta edhe publikuar ne platformen e e-prokurimit, andaj gjate inicimit te aktivitetit AK ka krijuar nje shkelje ligjore me daten 01.11.2024, duke e specifikuar nje kriter shtese sipas formularit B54 dhe se kriteri shtese nuk qe nje makineri apo nje staf profesional, mirepo qe kriter qe OE duhet te plotesoj 2 milion euro ne bank apo qasje ne kredi te pakushtezuar, andaj kriter te tilla percaktoj favorizime dhe diskriminonj palet e tjera te interesuara per kete aktivitet ne fjale, andaj vendosja e nje kriteri te tille 10 dit para ofertimit qe kriter diskriminues dhe favorizues, pasi qe DT nuk qe e pregaditur konform LPP-se dhe Rregullores Nr 001/2022 te Prokurimit Publik, e qe zyrtari prokurimit vazhdon po me te njejten shkelje, andaj ne menyre qe konkurenca te jete me konform rregullores dhe lpp-se AK duhet te vazhdoj afatin ligjore,

Gjate inicimit te aktivitet te prokurimit zyrtari ligjor i prokurimit eshte dashur te kete parasysh neni 7 paragrafi 6 i LPP-se ku thekson se Gjate udhe heqjes se aktiviteve te prokurimit, te gjitha autoritetet kontraktuese do te sigurojne; (i) pjese marrjen sa me te gjere te mundshme te operatoreve te interesuar ekonomik lidhur me c,imin dhe lende n e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dergimin dhe/ose disponueshmerine e te gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve qe kane te bejne me aktivitetin e prokurimit ne perputhje me kete ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kriterëve, kerkesave dhe specifikimeve teknike qe diskriminojne ne favor ose kunderr nje ose me shume operatoreve ekonomik; (iv) qe te gjitha specifikimet teknike dhe te gjitha kerkesat per perzgjedhje dhe dhe nie, duke perfshire rendesine relative te seciles kerkese dhe kriter te tille, si dhe metodat e perzgjedhjes dhe dhe nies te sakte sohen ne njoftimin e kontrates ose konkursit per rkate s te projektimit, ne ftesen per tender ose pjese marrje dhe/ose ne dosjen e tenderit; (v) qe asnje kerkese, kriter, specifikim qe nuk e shte sakte suar keshu, te mos perdozet ne procesin e perzgjedhjes ose dhe nies, dhe (vi) qe tenderi i zgjedhur te perputhet me te gjitha aspektet permbajtjesore te kushteve, kriterëve dhe specifikimeve per rkate se.,

Poashtu eshte dashur te kele parasysh neni 27 paragrafi 4 Kurdo qe nje aktivitet i prokurimit ke rkon publikimin e njoftimit te kontrate's, dosja e tenderit duhet te kompletohet para publikimit te njoftimit te kontrate's; KRPP-ja mund te vendose pe r monitorimin e ke'saj dispozite, me akte ne'nligjore.

Neni 17 paragrafi 17.5,17.17,17.18 i Rregullores Nr 001/2022 e Prokurimit Publik, Paragrafi 17.5 Zyrtari i Prokurimit e shte pe'rgjegje's pe'r pe'rgatitjene dosjes se tenderit. Ai e shte plote'sisht pe'rgjegje's pe'r pe'rgatitjen e dokumenteve te tenderit, knitereve te pe'rzgjedhjes, si dhe knitereve te dhe'nies, nde'rsa specififikimet teknike do te pe'rgatiten nga struktura te specializuara ne'c,e shtjen qe do te prokurohet, brenda AK. Ne' rastet e kontratave komplekse ose te vec,anta, AK mund te caktoje ekspert te jashte'm ose Kontraktore', pe'r te ndihmuar nje'sine' ne' hartimin e Dosjes se Tenderit. AK do te zbatoj dispozitat e LPP-se' kur angazhohen ekspert te jashte'm ose Kontraktore'.

Paragrafi 17.17- Dosja e tenderit do te pe'rgatitet ne' me'nyre' qe nuk: Kufizon konkurrence'n ne' mesin e OE, ose Diskriminon kunde'r ose vepron ne' favor te nje' ose me' shume' OE.

Neni 19 paragrafi 19.1 Ne' zbatim te Nenit 28 dhe 29 te LPP, AK do te specifikoj ne' dosjen e tenderit te gjitha specififikimet teknike te cilat c,do tender duhet ti pe'rm bush.

Dhe sidomos Neni 6 paragrafi 6.6 Reduktimi i afatit kohor mund te pe'rdore't vete'm ne'se:

- a. Njoftimi Paraprak ne' fjale' ka te gjitha informatat e nevojshme te specifikuara; dhe
- b. E'shte publikuar jo me' pak se 40 dite' dhe jo me' shume' se 12 muaj para publikimit te

Njoftimit pe'r Kontrate' ne' fjale'.

Andaj qe ne nje procedure prokurimit prej 24 diteve te shtohen knitere extra dhe zyrtari prokurimit te mos vazhdoj afatet kjo shihet qarte nje shkelje ligjore dhe nje shkelje favorizuese ndaj nje OE te caktuar qe ka arritur te krijoj qasje te tilla duke shtuar knitere permes b54, ne kemi kerkuar edhe nje sqarim shtese nga KRPP si qe e mundur qe keto knitere te plotesohen dhe te vazhdohen ne menyre te kunderligjshme, andaj qe lenda te mos shkoj ne OSHP dhe qe kjo procedure e prokurimit te jete me e favorshme , te largohet kniteri sipas formularit te B54 pasi qe shpreh favorizim dhe qe afati kohore te vazhdohet edhe per 10 dite te paktën sepse edhe pas korrigjimit sipas formularit ju nuk e keni korrigjuar as DT e qe eshte ne kundershtim me LPP duke i krijuar konfuzion dhe mos transparence efikase ndaj OE

Demet materiale sipas OE ankues:

Mos aplikimi na shtyen deri ne humbjen e keti aktivitetit te prokurimit dhe humbje ne imazhin e kompanise

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Si AK-MSh i kemi shqyrtuar pretendimet e juaja ankimore dhe mund te konstatojme se jane te pa bazuara, ndersa sa i perket afatit per ofertim pajtohemi te shtyhet per daten 18.11.2024.

Ne Kerkesen per rishqyrtim ju me shume keni cituar nene te LPP-se se sa qe keni dhene arsye te bazuara ne ankese, andaj si AK ne konsiderojme se keto kritere jane bazike per kete lami te aktivitetit, nuk jane diskriminuese apo favorizuese dhe mund te plotesohen nga nje numer mjaft i madh i OE te interesuar dhe serioz per realizimin me sukses te ketij projekti.

Si AK mbesim pas kritereve te percaktuara ne NJK dhe DT si dhe B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara, me te cilin bazuar ne pyetjet sqaruese te nje OE jane zbutur dy kritere, si dhe te kapaciteti ekonomik dhe financiar eshte shtuar kerkesa per mbeshtetje bankare 2 milion.

Ne fillim te vitit 2024 eshte publikuar Njoftimi Paraprak me titull "Ndërtimi i Institucioneve ISSH dhe QRSKP në Shtime" dhe mbi kete baze dhe konform ligjit, afatin per ofertim e kemi caktuar 25 dite, por pas kerkeses tuaj dhe me qellim te konkuresces sa me te gjere pajtohemi qe afati per ofertim te shtyhet per daten 18.11.2024.


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. ADRA GROUP CONSTRUCTION SH.P.K.
2. Operatoreve ekonomik te interesuar



Berat Marmullaku

ZPP, Udhëheqës i Div. te Prokurimit